

VENDIM
Nr.454, datë 23.6.2005

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR JOPUBLIK,
PARAUNIVERSITAR, SHKOLLË E MESME E PËRGJITHSHME, E PROFILIZUAR
“TURGUT OZAL”, QË DO TA ZHVILLOJË MËSIMIN EDHE NË GJUHËN ANGLEZE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e lejes për hapjen e institucionit arsimor jopublik, parauniversitar, shkollë e mesme e përgjithshme, e profilizuar “Turgut Ozal”, që do ta zhvillojë mësimin edhe në gjuhën angleze, në qytetin e Durrësit.
2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për të ndjekur zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore për arsimimin, edukimin dhe formimin në këtë institucion.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano